



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT DHE KOORDINIMIT  
SEKTORI EDUKIMIT DHE INFORMIMIT

Data 18.7.2024  
Nr. 2046/2 Prot.

FTESË PËR NEGOCIATË  
PËR

AGJENCITË E SPECIALIZUARA/ORGANE PËR SHËRBIMIN ARTGRAFIK, PËR REALIZIMIN/DISENJIMIN E TË GJITHA MJETEVE DHE MATERIALEVE QË DO TË PËRDOREN PËR FUSHATËN EDUKUESE, INFORMUESE DHE NDËRGJEGJËSUESE, NË KUADËR TË ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR KRYETARIN E BASHKISË HIMARË TË DATË 4 GUSHT 2024.

- Në zbatim të vendimit nr.1195, datë 05.08.2008, "Për blerjen, zhvillimin, prodhimin dhe bashkëprodhimin e programeve ose reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botim në median e shkruar dhe për kontratat, për kohën e transmetimit, nga organet e administratës shtetërore" të Këshillit të Ministrave, vendimit nr. 80 datë 15.07.2024, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për miratimin e strukturës së shpenzimeve buxhetore, për zgjedhjet e pjesshme në Himarë, 4 gusht 2024", vendimit nr.71 datë 9.07.2024, "Për miratimin e Programit të Edukimit, Informimit dhe Ndërgjegjësimit të Zgjedhësve, për zgjedhjet e pjesshme në Himarë", si dhe urdhrin nr. 51 datë 23.05.2024, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për delegimin e detyrave", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të realizojë "Spote televizivë edukues, informues dhe ndërgjegjësues, krimet zgjedhore, kontrollo emrin në listën e zgjedhjeve, hapat për të votuar, plotësimi korrekt i fletës së votimit, thirrje për pjesëmarrje për ndërgjegjësimin e të gjithë target grupet e synuara" për zgjedhjet e pjesshme për Kryetarin e Bashkisë Himarë, datë 4 gusht 2024,

OBJEKTI

Shërbimin artgrafik, për realizimin/disenjimin e të gjitha mjeteve dhe materialeve që do të përdoren për fushatën edukuese, informuese dhe ndërgjegjësuese, në kuadër të zgjedhjeve të pjesshme për kryetarin e bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024  
Periodha e realizimit: 2 (dy) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Fondi limit i përcaktuar: fondi limit i procedurës është në vlerën 400.000 (katërqind mijë) lekë pa Tvsh.

Afati përfundimtar për paraqitjen e dokumentacionit nga agjencitë e specializuara është më datë 19.07.2023 ora 16:00 nga momenti i publikimit dhe dërgimit të ftesave.

Dokumentacioni/ofertat duhet të vijnë të gjitha të mbyllura në zarf jotransparent, në një ditë të vetme, të firmosura dhe vulosura në emrin dhe adresën e subjektit dhe me shënimin: Mos e



hapni, me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm komisioni i vlerësimit të ofertave dhe jo përpara datës 19.07.2023, ora 16.00.

Në rast të kundërt ato do të refuzohen dhe do të kthehen të pahapura.

Rrjedhimisht jeni të lutur të paraqisni pranë Autoritetit tonë kontraktor:

Emri: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Adresa: Rruga "Ibrahim Rugova", Nr 4  
Adresa e Internetit: [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al)

***Në emër të Komisionit për ndjekjen e procedurave me objekt "Shërbimin artgrafik, për realizimin/disenjimin e të gjitha mjeteve dhe materialeve që do të përdoren për fushatën edukuese, informuese dhe ndërgjegjësuese, në kuadër të zgjedhjeve të pjesshme për kryetarin e bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024", kriteret do të jenë si më poshtë:***

**Gjuha për hartimin e ofertave është: Shqip**

## 1. TERMAT E REFERENCËS

**Qëllimi i kësaj fushate është:** Informimi, Edukimi dhe Ndërgjegjësimi i Zgjedhësve në Bashkinë Himarë, me qëllimin për tu ardhur në ndihmë zgjedhësve të kësaj Bashkie, që të informohen për hapat e procesit zgjedhor, kërkimin e emrit në listat e zgjedhësve, dokumentet që duhen në ditën e zgjedhjeve, mënyrën e plotësimit të fletës së votimit, krimet zgjedhore, e të tjera.

### Përshkrimi:

**Realizimi/disenjimi i të gjitha mjeteve dhe materialeve që do të përdoren, në kuadër të informimit, edukimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve për zgjedhjet e pjesshme për Kryetarin e Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024.**

Të gjitha posterat që do të përdoren në fushatën e edukimit të zgjedhësve në Bashkinë Himarë duhen të realizohen me grafika sipas përmasave dhe kriterëve të vendosura nga ne. Posterat/grafikat/banerat informuese, duhet të përmbajnë në fokus informacion të plotë dhe të detajuar për procesin zgjedhor të datës 4 gusht 2024. Posterat dhe banerat që duhet të realizohen në përputhje me standardet dhe teknikat më të avancuara duhet të jenë të përshtatshëm për formatin dhe përmasat e vendosura nga ne.

### Shërbimet që kërkohen të realizohen:

Realizimi/disenjimi i të gjitha mjeteve dhe materialeve që do të përdoren, në kuadër të informimit, edukimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve për zgjedhjet e pjesshme për Kryetarin e Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024 si më poshtë:



### **Karakteristikat:**

- Posterat për Qendrat e Votimit për “Hapat e Votimit”
- Posterat për Qendrat e Votimit për “Krimet Zgjedhore”
- Posterat “Kontrollo emrin në listën e zgjedhësve”
- Posterat për Qendrat e Votimit për “PAK”
- Posterat për Qendrat e Votimit për “Hapat e Votimit”, në gjuhën greke
- Posterat për Qendrat e Votimit për “Krimet Zgjedhore” në gjuhën greke
- Grafika e “Programit të Edukimit dhe Informimit të zgjedhësve, Bashkia Himarë
- Të gjitha mjetet e tjera që i shërbejnë fushatës edukuese dhe informuese, shoqëruar nga një seri imazhesh me mesazh zgjedhor.

### **Për realizimin e shërbimeve të mësipërme kërkohet paraprakisht:**

- Analiza e zgjedhjeve të kaluara,.

Operatori ekonomik duhet të realizojë shërbimet e përcaktuara më lart në funksion të objektit transmetimi i fushatës informuese në kuadër të zgjedhjeve të pjesshme të 4 gushtit.

Operatori duhet të dorëzojë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, materialet e përgatitura në hard copy në dy kopje dhe një kopje në CD në format të editueshëm.

Spotet duhet të përmbajnë sloganin kryesor, logon zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe ëbsite zyrtar të KQZ.

Materialet duhet të dorëzohen në Formatin HD.

Materialet e përshtatura për transmetim duhet të dorëzohen në format VIDEO HD1080, Format MP4 kopje në DVD/USB.

## **2.INFORMACION DHE KËRKESA SPECIFIKE NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK KRITERET E PRANIMIT/KUALIFIKIMIT**

### **Kriteret e përgjithshme:**

#### **Dokumentacion ligjor që duhet paraqitur për të plotësuar kriteret kualifikuese:**

- a. Ekstrakti historik i regjistrit tregtar.
- b. Vërtetim për statusin aktiv.
- c. Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme.
- g. Deklaratë mbi konfliktin e interesit.
- h. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur.
- i. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore.
- n. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike
- o. Kontrata të ngjashme të mëparshme.

*Dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.*

### **Kapacitet teknik dhe profesional**



1. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar në vitet/vitin e fundit nga data e shpalljes së njoftimit për negociata, kontrata të ngjashme në një vlerë jo më pak se 40% të fondit të parashikuar për këtë shërbim. Kjo do të vërtetohet me dokumentet e mëposhtme:
  - Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
2. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, me të cilën merr përsipër se ka kapacitetet e nevojshme për të konceptuar, realizuar dhe siguruar transmetimin e spoteve.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre të lëshuara jo më vonë se 3 (tre) muaj nga data e publikimit të njoftimit për negociata. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

*Afati i realizimit të shërbimit do të jetë sipas kërkesave të autoritetit kontraktor, duke filluar nga nënshkrimi i kontratës dhe sipas specifikimeve teknike në Ftesën për Ofertë.*

*Në ofertën e tij, ofertuesi duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit.*

*Përzgjedhja e ofertave do të bëhet sipas pikës nr. 7 dhe 12, të VKM nr.1195 datë 05.08.2008.*

### 3. KRITERET E VLERËSIMIT

- **Kriteret e përgjithshme: 10**
- **kapaciteti financiar:10**
- **Kapacitet teknik dhe profesional 30**
- **Oferta financiare e shoqëruar me Projekt propozimin për realizimin e kontratës 50**

**Vlerësohet me 30 pikë dokumentacioni ligjor i paraqitur.**

**Vlerësohet me 20 pikë eksperiencia e mëparshme e operatorit ekonomik.**

**Vlerësohet me 50 pikë çmimi i ofruar nga organi i masmedias/agjencia e specializuar.**

Oferta ekonomike do të jetë e paraqitur në lekë, me TVSH.

Ofertuesit kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e hapjes së ofertave, përfaqësuesit apo personat me autorizim.

Ofertat duhet të jenë të mbyllura në zarf, të vulosura dhe do të dorëzohen nga përfaqësuesit e shoqërive zyrtarisht pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Zyra e Protokollit, përpara orës së përcaktuar.

Komisioni nuk do të pranojë asnjë ofertë e cila do të dorëzohet përtej afatit të përcaktuar dhe jo në përputhje me kërkesat e mësipërme.

Kjo ftesë për negociata do të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në adresën: [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al)

**Jemi në pritje të konfirmimit tuaj për negociim.**

